

Ndryshimet Klimatike: një e ardhme e zymtë

*nga Edvin Pacara, Instituti i Politikave Mjedisore
2 Mars 2009*

Në fillim të viteve 2000, shkencëtarët paralajmëruan se ngrohja globale do të shkrijë akullnajat në male dhe në polin e veriut e atë të jugut në një periudhë prej rreth 100 vjetësh. Raporti Vlerësues i Katërt mbi Ndryshimet Klimatike i Panelit Ndërqeveritar i Ndryshimeve Klimatike (PNNK) i publikuar në 2007, paralajmëroi se ngrohja globale mund të rrisë nivelin e deteve me 0.4-3.7 m mbi nivelet e periudhës para revolucionit industrial. Por në vitin 2009 shkencëtarët u alarmuan nga të dhënat e fundit që po vinin nga polet—akullnajat po shkrinin me një ritëm shumë më të shpejtë sesa pritej—shtresat e akullit në Oqeanin Arktik mund të zhdukeshin në 2020-2040.

Tani imagjinoni sikur jeni në të ardhmen në vitin 2025 dhe sikur gazrat serrë kanë vazhduar të çlirohen gjithnjë e në rritje.

Në Dhjetor 2009, liderat botëror u mbledhën në Konferencën mbi Ndryshimet Klimatike në Kopenhagën ku ata vendosën të ulin në minimum çlirimin e CO₂ dhe gazrave të tjerë serrë dhe gjithashtu vendosën një sistem global të tregut të karbonit. Sistemi ishte perfekt në teori por dështoi në zbatim—vendet në zhvillim nuk qenë të afta të vendosnin kufizime ndaj çliruesve të gazrave serrë, shumë qeveri nuk kishin vullnetin politik dhe burimet për të zbatuar sistemin, të tjera thjesht ranë pre e vështirësive ekonomike dhe vështirësive të tjera. Niveli i gazeve serrë vazhdoi të rritej pa u ndalur në atmosferë deri në 2025...

Efektet e ngrohjes globale në 2025: një skenar i mundshëm

Efektet e ngrohjes globale po ndihen në të gjithë globin: rajonet me klimë të butë në të kaluarën, po vuajnë nga thatësira të zgjatura në verë dhe përmbytje të mëdha në dimër. Si rezultat i thatësirave, zjarreve, zisë së bukës dhe luftërave, miliona njerëz janë kthyer në refugjatë klimatikë. Dy të tretat e Afrikës janë kthyer në një zonë pa shtet ku milicite luftojnë për burimet e fundit të mbetura dhe civilët po vriten pa dallim. Rajoni i Mesdheut në Evropë po vuan nga thatësirat e tejzgjatura dhe zjarret në verë, gjë që ka shkaktuar miliona njerëz të emigrojnë në vendet Nordike dhe ato Balltike ku klima është bërë më e butë dhe ekonomia po ecën mirë. Shumë shtete i janë kthyer proteksionizmit dhe kufijtë detarë e tokësorë të Evropës janë të mbyllur dhe patrullohen e mbikëqyren nga ushtritë.

Temperaturat janë rritur me 2.5 Gradë Celsius mbi ato të periudhës së Revolucionit Industrial. Akujt në polin e veriut po shkrijnë me një ritëm gjithnjë e në rritje duke krijuar lumenj masivë në Kanadanë e veriut dhe Grenlandë. Me mijëra liqene u krijuan dhe po rriten në sipërfaqen e Grenlandës si pasojë e shkrirjes së akullnajave.

Në verë të 2025-ës ndodhi ajo që shkencëtarët kishin kohë që e kishin parashikuar dhe i druheshin. Liqenet në Grenlandë u frynë dhe u bashkuan me njeri tjetrin, duke krijuar një liqen gjigant mbi shtresat e akujve, brigjet e të cilit ishin mure prej akulli. Volumi i këtij liqeni u rrit aq shumë sa që bregu jugor i këtij liqeni shpërtheu. Një volum uji i barabartë me atë të dhjetë herë ai i lumit Amazona, u derdh në pjesën veriore të oqeanit Atlantik. Kripësia ra menjëherë në një zonë të madhe të Atlantikut në verilindje të brigjeve të Kanadasë dhe në jug të brigjeve të Grenlandës, gjë që ngadalësoi rrymën Golfstrim, e cila pushoi së rrjedhuri pas disa ditëve.

Pasojat e kësaj ngjarjeje janë katastrofale për Evropën dhe Amerikën Verilindore. Vjeshta vjen më temperatura të ulëta dhe stuhi bore në Amerikën Verilindore, Irlandë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Evropën Perëndimore. Pemët zihen nga stuhia me gjethet ende në degë, kafshët shtegtuese janë çoroditur nga ky sulm i paparashikuar i të ftohtit dhe akullit, lumenjtë janë të ngrirë, rrugët të bllokuara dhe ka mungesa elektriciteti të zgjatura në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, SHBA-në dhe Evropën Perëndimore. Nga mesi i periudhës së dimrit, Irlanda po vuan dimrin më të ftohtë në historinë e saj dhe nuk mund të quhet më Ishulli i Gjelbër, ajo mund të quhet më mirë Ishulli i Bardhë, pasi bora dhe akulli e kanë mbuluar të gjithë ishullin. Mbretëria e Bashkuar është e paralizuar: temperaturat kanë rënë në -20° C, sistemi i transportit ka dështuar, telat dhe shtyllat elektrike po shemben nga pesha e madhe e borës dhe akullit, çdo ditë me qindra njerëz vdesin nga i ftohti i pazakontë për ishullin, lumi Tamiz është i mbuluar nga shtresa të trasha akulli, çatitë e shumë shtëpive po shemben nga pesha e borës dhe infrastruktura është dëmtuar rëndë. Në Evropën Perëndimore, qytetet e pamësuara me këtë të ftohtë, janë krejtësisht të paralizuara—gazi rus që më parë ngrohte këto qytete, tashmë nuk kalon më në tubat e tyre dhe miliona të moshuar po vdesin në apartamentet e veta që tashmë janë kthyer në dhoma frigoriferike. Shumë të tjerë po vdesin nga të ftohtët në SHBA-në Verilindore dhe Evropën Perëndimore—janë të varfrit ata që po vuajnë më tepër barrën e kësaj katastrofe. Me qindra mijëra të pastrehë (pasoje e krizës së gjatë ekonomike në vitet e mëparshëm) vdesin nga të ftohtët që në javët e para të këtij dimri të ashpër. Ekonomia është gjunjëzuar, prodhimi dhe tregtia janë paralizuar, mungesat e zgjatura të elektricitetit tashmë janë bërë të zakonshme dhe njerëzit po djegin çdo gjë të djegshme për t'u ngrohur. Duke qenë krejtësisht të varur tek teknologjia, jetët e njerëzve po shkatërrohen gjatë kësaj katastrofe.

Akujt shkrijnë në pranverë, duke u dhënë njerëzve pak shpresë, por më e keqja ende nuk ka ardhur. Pranvera sjell pak shi, vera vjen me mot shumë të nxehtë, të thatë dhe pa ndonjë reshje. Drithërat vyshken nëpër ara (tani nga i nxehti dhe thatësira), lumenjtë thahen, dhe ekonomitë e shumë vendeve të Evropës hyjnë në depresion të thellë. Në shumë vende të BE-së plasën trazirat sociale. BE-ja vetë shpërbëhet pasi çdo vend i saj mundohet të mbrojë qytetet dhe burimet e veta të mbetura. Evropa Qendrore dhe Jugore shkretohet nga një seri dimrash të ashpër që ndiqen nga vera të nxehta e thata.

Klima vazhdoi të ngrohet në mbarë globin në 10 vitet në vazhdim pas 2025; në fund të kësaj periudhe, dimrat u bënë më të butë por verat u bënë të gjata dhe me pak ose aspak shi. Rajone të mëdha në Spanjë dhe Itali u kthyen në shkretëtira kurse Ballkani dhe Evropa Qendrore u kthyen në rajone gjysmë-shkretinore. Konfliktet shpërthyen në vendet e Evropës Juglindore për të vënë nën kontroll burimet e ujit, konflikte që shkaktuan miliona refugjatë që vërshuan drejt Evropës Veriore, ku klima u bë e përshtatshme dhe favorizuese për jetesë—me reshje të shumta dhe dimra të butë. Krizat e refugjatëve favorizuan ardhjen në pushtet të diktaturave të fuqishme në vendet e lartpërmendura, diktatura që mbyllën kufijtë për refugjatet dhe mbronin më fanatizëm burimet e tyre natyrore.

Çfarë duhet të bëjmë për të ngadalësuar dhe minimizuar ngrohjen globale?

Skenari i mësipërm mund të bëhet realitet nëse ne nuk marrim masa urgjente. Ngruhja globale është një realitet tashmë i pamohueshëm; historia e Tokës na tregon se nivelet e CO₂ në atmosferë janë të lidhura pozitivisht me rritjen e temperaturave globale. Gjithashtu, faktet tregojnë se është e qartë që ne njerëzit po shkaktojmë ngrohjen globale. Prandaj, ne jemi ata që mund ta ngadalësojmë ose ta ndalojmë atë.

Në mënyrë që ta arrijmë këtë, të gjitha vendet (sidomos ato të zhvilluara) duhet:

- të japin më shumë fonde ose të paktën të arrijnë 33 % të nivelit të investimeve “të gjelbra” në paketat nxitëse fiskale të planifikuara, ashtu siç u propozua nga UNEP në Marrëveshjen e Re të Gjelbër;
- të riorientojnë ekonominë drejt industrive “të gjelbra” dhe të qëndrueshme;
- të japin më shumë teknologji, ndihmë financiare dhe ekspertizë vendeve në zhvillim dhe atyre të varfra në mënyrë që të luftojnë dhe të përshtaten ndaj ngrohjes globale si dhe të parandalojnë një katastrofe humanitare;
- të fillojnë një fushatë masive ndërgjegjësimit mbi pasojat e ngrohjes globale dhe masave për ta parandaluar që këto pasoja të ndodhin;
- të përdorin “shkopin dhe karrotën” (stimuj dhe gjoba) për të drejtuar popullatën drejt një jetese më “të gjelbër”.

Rekomandimet e mësipërme duhet të zbatohen sa më shpejtë që të jetë e mundur—njerëzimit po i mbarohet koha për të vepruar dhe pika e moskthimit është shumë afër; çdo ditë që kalon është një shans i humbur në luftën kundër ngrohjes globale. Megjithatë, nëse veprojmë tani, është ende e mundur ta përballojmë këtë krizë.